



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:041811

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05694639

C.nr.341/21

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Z. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin me autorizim e përfaqëson av. Adem Aliu nga Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të cilën e përfaqëson avokatura shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, me objekt kontesti kompensimi i pagave përcjellëse, jubilarë, shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 4767.26€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik, me datë 16.05.2024 ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit E.Z. nga fshati ...-Komuna Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që paditësit E.Z. në emër të tri pagave përcellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit (neto paga për muajin 08/2020 – 542.71€, neto paga për muajin 09/2020-542.71€, neto paga për muajin .../2020-725.05€ * 18....47€ / 3 * 603.49€), me rastin e pensionimit të paguaj shumën neto prej 18....47€, në emër të shpërblimit të pagave jubilarë për 20 vite përvojë pune vlerën prej 75% të pagës bazë neto shumën prej 380.08€, për 30 vjet përvojë pune vlerën e njëjtë të pagës bazë, neto shumën prej 542.71€ dhe për 40 vite përvojë pune vlerën prej 150% të pagës bazë, neto shumën prej 814€, gjithsej shumën neto prej 1736.79€, në emër të shpërblimit për shujtat për vitin 2018 për 220 ditë pune 440€, për vitin 2019 për 220 ditë pune shumën prej 440€, për vitin 2020 për 170 ditë pune shumën prej 340€, gjithsej për shujtat 1220.00€, gjithsej shuma për kërkesëpadinë 4767.26€, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 425€, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Adem Aliu nga Ferizaj, më 04.03.2021, kanë ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i pagave përcjellëse, jubilarë, shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, vlera e kontestit 4767.26€. Në padi kanë theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive e Arsimit e Kosovës e datës 18.04.2017, nenit 35.9, pika 9.1, e paditura ka qenë e obliguar që paditësit t'ia kompensoj shujtën ditore, pagën përcjellëse, shpenzimet të udhëtimit, dhe pagën jubilarë sipas përvojës së punës si dhe obligimet tjera të cilat burojnë nga kjo kontratë, të cilat asnjëherë nuk i ka përmbushur. Në shqyrtimin gjyqësor, i autorizuari i paditësit av. Adem Aliu nga Ferizaj e ka precizuar kërkesëpadinë sipas parashtrësës së dt. 09.11.2023, me të cilën kërkon të detyrohet e paditura që paditësit në emër të tri pagave përcellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit (neto paga për muajin 08/2020 – 542.71€, neto paga për muajin 09/2020-542.71€, neto paga për muajin .../2020-725.05€ * 18....47€ / 3 * 603.49€), me rastin e pensionimit të paguaj shumën neto prej 18....47€, në emër të shpërblimit të pagave jubilarë për 20 vite përvojë pune vlerën prej 75% të pagës bazë neto shumën prej 380.08€, për 30 vjet përvojë pune vlerën e njëjtë të pagës bazë, neto shumën prej 542.71€ dhe për 40 vite përvojë pune vlerën prej 150% të pagës bazë, neto shumën prej 814€, gjithsej shumën neto prej 1736.79€, në emër të shpërblimit për shujtat për vitin 2018 për 220 ditë pune 440€, për vitin 2019 për 220 ditë pune shumën prej 440€, për vitin 2020 për 170 ditë pune shumën prej 340€, gjithsej për shujtat 1220.00€, gjithsej shuma për kërkesëpadinë 4767.26€, si dhe shpenzimet procedurale në lartësi prej 425€, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

E paditura përmes përfaqësuesit ligjor-avokatura shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, në përgjigje në padi të dt. 07.02.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura ku dhe ka gëzuar të drejtat nga marrëdhënia e punës. Paditësi me vendim ref. ... nr. prot. ... është pensionuar më2020 dhe nuk ka parashtruar ankesë brenda afatit 30 ditor pranë institucionit të paditurës prandaj padia e dorëzuar në gjykatë është e pasafatshme. Po ashtu, lënda duhet të trajtohet në departamentin administrativ të Gjykatës

Themelore në Prishtinë, si kompetente për trajtimin e shërbyesve civil/administrativ. Tutje, kërkesëpadia e paditësit është mbështetur në Kontratën Kolektive e Arsimit e Kosovës e datës 18.04.2017, e paditura vlerëson se paditësi ka pasur statusin e shërbyesit civil e që kontrata kolektive sektoriale ku dhe është mbështetur nuk ka bazë ligjore, se kjo kontratë rregullon marrëdhënien e punës të drejtat për punonjësit e arsimit, po ashtu asnjë dispozitë ligjore e kësaj kontrate nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte, kompensimet jubilarë gjegjësisht shujtat dhe shpenzimet e udhëtimit. Mbështetur në aktemërimin e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës pozita e paditësit ishte Inspektor i arsimit profesional në Ferizaj e që konstatojmë se ka pasur statusin e shërbyesit civil. Kontratën Kolektive e Arsimit e Kosovës ka për qëllim rregullimin e punonjësve në institucionet arsimore. Paditësi nuk ka dëshmuar se ka qenë anëtar i sindikatës e paraparë me dispozitën e nenit 2, par. 1.1 të Kontratës Kolektive e Arsimit e Kosovës. Po ashtu edhe po të është anëtar i sindikatës e që si anëtar i sindikatës apo vet SBASHK-u nuk ka asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare. Nuk ka dëshmuar me prova dhe dëshmi lidhur me transportin nga shtëpia në shkollë e me të cilën e paditura do të obligohej për kompensim të ushqimit dhe transportit për periudhën sipas kërkesëpadiës. Vlen të theksohet se aktemërimi ndërmjet paditësit dhe të paditurës asnjë dispozitë nuk parasheh kompensimin sipas kërkesëpadiës. Marrëdhënia e punës ka përfunduar me arritjen e pensionimit. Paaditësi është pensionuar me arritjen e moshës 65 vjeçare më2020 ndërsa padia është dorëzuar në gjykatë pas afatit prej 30 ditësh e që kontrata kolektive sektoriale për arsim rregullon çështjen e të punësuarve e jo të pensionuarve. Paditësi ka shfrytëzuar të drejtën e kërkesës për realizimin e njohjes së të drejtës në pension. Kontrata Kolektive e Arsimit e Kosovës është lidhur për periudhë tri vjeçare, e që konstatohet se nuk është në fuqi. Po ashtu është fakt notor se gjatë vitit 2020 nuk kanë punuar/udhëtuar mësimdhënësit/paditësi me vijim të rregullt të punës, për shkak të pandemisë COVID-19. E që nga kjo rrjedh se e paditura nuk obligohet të kryej shpenzimet e ushqimit e udhëtimit për të cilat nuk është kryer/udhëtuar për punën mësimore, e që paditësi ka kryer punë zyrtare si shërbyes civil. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: vërtetim i lëshuar nga Komuna Ferizaj-DKA nr. prot. .../03, i dt. 21.09.2020, vërtetim i lëshuar nga Komuna Ferizaj-DKA pa datë, gjendja e llogarisë bankare nr. ... e dt. 23.....2020, aktemërimi i

lëshuar nga e paditura i dt. 11.05.2012, vendim për pensionim i lëshuar nga e paditura ref:..., nr. prot. ..., i dt. 07.05.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar.

Me leximin e vërtetimit i lëshuar nga Komuna Ferizaj-DKA nr. prot. .../03, i dt. 21.09.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi nga periudha 01.01.1990-31.08.1994 kishte 4 vite e 8 muaj përvojë pune.

Me leximin e vërtetimit i lëshuar nga Komuna Ferizaj-DKA pa dt., gjykata vërtetoi faktin se paditësi nga periudha 01.09.1994-31.08.1999 kishte 5 vite e 1 muaj përvojë pune.

Me leximin e gjendjes e llogarisë bankare nr. ... e dt. 23.....2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi kishte pranuar të holla në formë të pagës në shumën prej 540.64€ më dt. 28.02.2020.

Me leximin e aktemërimit i lëshuar nga e paditura i dt. 11.05.2012, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ishte i punësuar si Inspektor i arsimit profesional në Ferizaj, dt. e fillimit 02.04.2012.

Me leximin e vendimit për pensionim i lëshuar nga e paditura ref:..., nr. prot. ..., i dt. 07.05.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i pushon marrëdhënia e punës më2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata ka vendosur që ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk është punonjës i cili është kategorizuar si punonjës i arsimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, por shërbyes civil, ashtu siç është kategorizuar me Ligjin për Shërbimin Civil. Sipas kësaj kontrate, në nenin 2 par.1 pika 1.1 parashihet që “Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”. Kjo dispozitë në mënyrë taksative i ka paraparë kategoritë të cilët janë përfitues të Kontratës kolektive sektoriale të arsimit në Kosovë.

Paditësi me të paditurën ka lidhur Aktemërim dhe i njëjti ishte i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës si Inspektor i arsimit profesional në Ferizaj, dt. e fillimit 02.04.2012, mbi këtë bazë i njëjti nuk është mësimdhënës, por shërbyes civil, i emëruar me akt emërim sipas Ligjit për Shërbimin Civil. Po ashtu paditësi në rend të parë kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të vitit 2017, duke mos prezantuar si provë që është anëtar i SBASHK-ut, ndërsa në nenin 5.2 të Kontratës Kolektive e Arsimit e Kosovës të datës 18.04.2017 parashihet se “Anëtarë të SBASHK-ut konsiderohen vetëm ata mësimdhënës, mësimdhënës universiteti, punonjës shkencorë, të kulturës apo personel ndihmës, personel administrativ, që janë deklaruar me shkrim për anëtarësimin në SBASHK, nënshkruese e kësaj kontrate, dhe që paguajnë rregullisht kuotizacionin sindikal sipas mënyrës dhe masës që përcaktohet nga organet drejtuese të SBASHK-ut”. Kërkesëpadia e paditësit është mbështetur në Kontratën Kolektive e Arsimit e Kosovës e datës 18.04.2017, por se kjo kontratë rregullon marrëdhënien e punës të drejtat për punonjësit e arsimit, po ashtu asnjë dispozitë ligjore e kësaj kontrate nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e kësaj të drejte, kompensimet jubilarë gjegjësisht shujtat dhe shpenzimet e udhëtimit. Po ashtu dispozitat e Kontratës Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë), qendrat burimore në kuadër të MASH-it dhe qendrat e kompetencës në kuadër të AAAPARR), shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, (komunat - DKA-të, KD-të - universitetet, institucionet e arsimit të lartë, shtëpitë e studentëve, qendrat burimore në kuadër të MASH-it, qendrat e kompetencës, në kuadër të AAAPARR, MASH-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Pretendimi i të paditurës se lidhur me kërkesëpadinë e paditësit është e kompetencës lëndore Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe jo kjo Gjykatë është i pabazuar, ngase paditësi me padinë e tij nuk ka kërkuar anulimin e ndonjë akti administrativ, të nxjerrë në procedurë administrative të ndonjë organi administrativ, por i njëjti nga gjykata ka kërkuar që t’i kompensoj të ardhurat personale përkatësisht pagat përcjellëse, jubilarë, shujtat dhe shpenzimet e udhëtimit.

Në nenin 15, par. 1, pika 1.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative i Kosovës është përcaktuar se: “1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.1. kundër akteve të nxjerra në çështjet,

në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ;”. Ndërkaq kjo gjykatë e pranon përfundimin se, paditësi gëzon mbrojtje gjyqësore sipas ligjeve të veçanta. Andaj për këtë arsye Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike, pasi që kemi të bëjmë me raport juridik civil. Sepse në bazë të nenit 17, par. 1 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj. Ndërsa në bazë të nenit 20, par. 1 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.

Për më shumë, po ashtu edhe po të është anëtar i sindikatës e që si anëtar i sindikatës apo vet SBASHK-u nuk ka asnjë angazhim të vetëm apo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave për sigurimin e mjeteve brenda mundësive financiare. Nuk ka dëshmuar me prova dhe dëshmi lidhur me transportin nga shtëpia në shkollë e me të cilën e paditura do të obligohej për kompensim të ushqimit dhe transportit për periudhën sipas kërkesëpadisë. Vlen të theksohet se aktemërimi ndërmjet paditësit dhe të paditurës asnjë dispozitë nuk parasheh kompensimin sipas kërkesëpadisë. Marrëdhënia e punës ka përfunduar me arritjen e pensionimit. Po ashtu është fakt notor se gjatë vitit 2020 nuk kanë punuar/udhëtuar mësimdhënësit/paditësi me vijim të rregullt të punës, për shkak të pandemisë COVID-19. E që nga kjo rrjedh se e paditura nuk obligohet të kryej shpenzimet e ushqimit e udhëtimit për të cilat nuk është kryer/udhëtuar për punën mësimore, e që paditësi ka kryer punë zyrtare si shërbyes civil.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale dhe ka shqyrtuar pretendimet e paditësit (gojore dhe atyre me shkrim), por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritorë të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 143 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:041811
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05694639

Datë 16.05.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.